



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112 - 21861/2023

Klinë, datë 04/07/2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

## V E N D I M

*Për formimin e grupit punues për hartimin e draft buxhetit për vitin 2024*

1. **CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e projekt propozimit- Draft Buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2024. Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
  - 1.1. **Melihate Behramaj, kryesuese;**
  - 1.2. **Vlora Tafili, anëtare;**
  - 1.3. **Njomza Jaha, anëtare;**
  - 1.4. **Fetah Elezaj, anëtarë si dhe;**
  - 1.5. **Arbëresha Tanushi, anëtare.**
2. Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt propozimit- Draft Buxhetit për vitin 2024, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga diskutimet publike dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera qe dalin nga dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe autorizimeve tjera ligjore e nënligjore.
3. Me rastin e përgatitjes së draft buxhetit para datës 1 shtator duhet të njoftohet kryetari i komunës lidhur më projekt propozimin.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtorja e Financave;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,  
Zenun Elezaj

